



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01.Nr. 16-30561/15
Kaçanik, 29. 09. 2015

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqëverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 shtator, 2015, mori këtë:

VENDIM

Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të trungjeve të dushkut Quercus sp, në fshatin Ivajë, si monument i natyrës

1. Me këtë Vendim merren nën mbrojtje vlerat e natyrës tri trungje të dushkut (Quercus sp) në fshatin Ivajë –Komuna e Kaçanikut si monument i natyrës i karakterit botanik (në tekstin e mëtejshëm: Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i Natyrës ndodhet në lagjen e Mulakëve në lartësinë mbidetare 927 m, ngastra kadastrale nr. 00559-0, koordinatat; **LAT:42.192072, LONG:21.241721.**

1.2. Dy trungje kanë dëmtimë në pjesën e brendshme që do të thotë se ka nevojë për intervenim.

1.3. Trungu i tretë është në gjendje të mirë natyrore,

1.4. Moshja e trungjeve sillet rreth moshës 450.

1.5. Këto trungje – monumente të natyrës kanë kurorë të mirë dhe të pa dëmtuar.

2. Monumenti i natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/ Natural Landmark –Monument i Natyrës.

2.1. Për monumentin e natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të mbrojtjes, në të cilin përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në Monumentin e Natyrës ndalohet:

2.1.1. Prerja e trungjeve, thyrja (krasitja) e degëve, mbledhja e gjetheve,

2.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

2.1.2. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqës mbrojtur ,

2.1.4. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur ,

2.1.5. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur ,

2.1.6. Hapja e varrezave në sipërfaqen e mbrojtur dhe

2.1.7. Çdo lloj aktiviteti tjetër i cili mundë të shkaktojë ndryshimin apo dëmtimin e

2.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

2.2.1. Të gjitha masat mbrojtëse biologjike-teknike të monumentit të natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit të natyrës.

3. Në zonën buferike të monumentit të natyrës ndalohet:

3.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi mbeturinave dhe mbetjeve tjera ,

3.2. Ndërrimi kulturës ,

3.3. Ngjitja e objekteve të cilat kanë ndikim në pengimin e pamjes së monumentit të natyrës.

4. Për zbatimin e masave mbrojtëse të monumentit të natyrës kujdeset Komuna e Kaçanikut. Komuna është e detyruar :

4.1. Monumentin e natyrës ta mbrojë dhe ta mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtëse,

4.2. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose ti dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tyre, menjëherë duhet ta lajmërojë Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

4.3. Të bëjë shënimin e kufinjëve të monumentit të natyrës në pajtim me Rregulloren për shenjimin e Zonave të Mbrojtura.

5. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, baza ekonomike-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e monumentit të natyrës.

6. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikqyrës-MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike.

Më këtë Vendim njeftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
3. Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike,
4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi